



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 04.12.2018, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Eduard Shalsi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Prezantimi i projektligjit "Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë". (*Komision për dhënie mendimi*)
2. Prezantimi i projektligjit "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Eduard Shalsi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Eglangtina Gjermani, Andrea Marto, Rakip Suli, Ilir Ndraxhi, Tatiana Nurçe, Robert Bitri, Dritan Bici, Edmond Leka dhe Vullnet Sinaj.

Mungojnë:

Florjon Mima, Endri Hasa, Izmira Ulqinaku, Lorenc Luka, Hekuran Hoxhalli, Lefter Koka, Rrahman Rraja, Gjetan Gjetani dhe Agron Çela.

Të ftuar:

Teuta Vodo – zëvendësministre e Drejtësisë
Artan Lame – Drejtor i Përgjithshëm i ALUIZNI-t
Edvin Kukunja – Këshilltar i ministres së Drejtësisë
Besnik Maho – Këshilltar i ministres së Drejtësisë
Majlinda Bozgo – Përgjegjëse e Sekretariatit Teknik të Komisionit Qeveritar të Tokës në Ministrinë e Bujqësisë
Lorena Goxhobelli – Këshilltare e ministrit të Bujqësisë

HAPET MBLEDHJA

Eduard Shalsi – Para se të kalojmë tek axhenda e kësaj jave dhe tek axhenda e ditës së sotme, miratojmë fillimisht procesverbalin e mbledhjes së kaluar. Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Atëherë, miratohet procesverbali.

Gjithashtu, gjej rastin të falënderoj kolegët deputetë edhe për pjesëmarrjen aktive, edhe për propozimet, një pjesë e mirë e të cilave u morën në konsideratë si për buxhetin e shtetit, ashtu edhe për paketën fiskale, me ndonjë përjashtim, për të cilin ne duhet të jemi të vëmendshëm!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Baraj, bëhet fjalë për merakun e taksës së plastikës.

Ndërkohë, jemi shumë të kënaqur që propozimet tona për zhavorrin bituminoz, edhe për pullat fiskale, edhe për rentën minerare, madje edhe propozimi ynë në lidhje me taksën e tokës dhe kategoritë e bashkive, si dhe rialokimet e buxhetit të ministrisë janë marrë në konsideratë, duke përfshirë edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, edhe akcizën e fishekzjarrëve, Vullnet, e cila nuk u hoq.

Mbetet vetëm të ndjekim me shumë kujdes dhe me shumë merak çështjen e plastikës, për të parë se çfarë impakti do të ketë në prodhimin vendas.

Edhe një herë, faleminderit kolegëve për të gjithë pjesëmarrjen aktive dhe për propozimet, si dhe për debatet e frytshme që kemi zhvilluar në komision!

Vazhdojmë me axhendën e kësaj jave, që e kemi të gjithë përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E doni fjalën për procedurë?

Po, urdhëroni!

Ilir Beqaj – Në mbështetje edhe të atyre që parashtruat ju, unë mendoj se duhet të tregojmë vëmendje edhe në ndjekjen e zbatimit të përjashtimit të TVSH-së tek inputet bujqësore.

Eduard Shalsi – Po.

Ilir Beqaj – Të shohim edhe sa do të reflektohet në treg, në mënyrë që të përfundojë te fermeri. Sepse, në qoftë se e heqim TVSH-në dhe çmimet mbeten sa janë sot, praktikisht...

Eduard Shalsi – Në rregull.

Ilir Beqaj – Faleminderit!

Eduard Shalsi – Ju falënderoj, zoti Beqaj, që sollët në vëmendje të komisionit një çështje për të cilën jemi shqetësuar të gjithë!

Ju e dini që mbështetjen për inputet bujqësore e kisha kondicionuar edhe me një sistem gjurmueshmërie, *track and trace*, pra që nga futja e mallrave në Shqipëri deri te përdoruesi fundor.

Unë vazhdoj të kem bindjen se pa një sistem adekuat gjurmueshmërie do ta kemi shumë të vështirë ta ndjekim ecurinë e çmimit, por, mbi të gjitha, edhe të sigurohemi që përfituesit kryesorë të kësaj mase do të jenë fermerët. Pra, mbetet në diskrecionin tonë që ta ndjekim me shumë kujdes këtë çështje.

Në axhendën e kësaj jave kemi parashikuar disa mbledhje.

Sot do të fillojmë me dy prezantime projektligjesh, do të thosha të shumëpritura, ndërkohë që nesër dhe pasnesër kemi lënë respektivisht heqjen e linjës *roaming* me Kosovën, si dhe ligjin “Për turizmin”.

Biem dakord me axhendën e kësaj jave?

(*Të pranishmit shprehen dakord.*)

Në rregull.

Atëherë, siç e thashë, sot kemi prezantimin e dy projektligjeve.

Të ftuar në komision kemi: zonjën Vodo, zëvendësministre e Drejtësisë; zotin Lame, drejtor i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, si dhe zonjat Majlinda Bozgo dhe Lorena Goxhobelli nga Ministria e Bujqësisë, të cilëve u uroj mirëseardhjen në komision!

Ne nuk jemi komision përgjegjës, komision përgjegjës është Komisioni i Ligjeve, por kemi qenë të angazhuar vazhdimisht në çështje të ndryshme, që kanë të bëjnë me pronësinë dhe me procese, për të cilat jemi dëshmitarë se gjatë gjithë kësaj periudhe tranzicioni, përveçse kanë qenë të komplikuar, ka pasur shpeshherë një mishmash institucional. Prandaj jemi shumë të gëzuar që kemi dy ligje, që shpresojmë se do t’u hapin udhë zgjidhjes së problemeve të akumuluar prej kohësh.

Relatore kemi zonjën Gjermani.

Fillimisht do të dëgjojmë prezantimin nga të ftuarit, për të vijuar me pyetje dhe përgjigje nga kolegët, për ta mbyllur në fund me diskutime, komente ose vërejtje, nëse do të ketë. Biem dakord me rendin e ditës?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Dakord.

Pa humbur kohë, fjala është për ju, zonja Vodo.

Teuta Vodo – Mirëdita, zoti Shalsi!

Shumë faleminderit për fjalën!

Bazuar në urdhrin e Kryeministrit nr. 201, datë 21.11.2017 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit të posaçëm të punës për riorganizimin e institucioneve të pronësisë dhe rishikimin e kuadrit ligjor” është ngritur grupi i punës, i kryesuar nga drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, i përbërë gjithashtu nga përfaqësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në Kryeministri, ALUIZNI-t, Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike dhe Agjencisë së Trajtimit të Pronave.

Në ushtrim të të drejtave dhe detyrave të ngarkuara, grupi i punës vlerësoi në tërësi situatën me lëshimin dhe regjistrimin e titujve të pronësisë, kuadrin ligjor dhe organizimin funksional për institucionet qendrore dhe vendore, që zhvillojnë aktivitetet në fushën e të drejtës së pronës.

Vizioni i nismës është pasja e një sistemi të konsoliduar të titujve të pronësisë, që nënkupton se çdo pronë duhet të jetë e regjistruar, e pasqyruar dhe të ketë një pronar të identifikueshëm.

Linjat e përgjithshme dhe parimet orientuese do të mbështeten në disa pika.

Pika e parë ka të bëjë me deburokratizimin dhe deregulimin, që do të thotë se nga mekanizmi aktual ligjor do të eliminohet çdo hallkë e panevojshme që shkakton, nënkupton shkurtimin e procedurave dhe të dokumentacionit që shoqëron procesin administrativ, duke lehtësuar barrën burokratike që rëndon mbi subjektet e interesuara (pronarët, poseduesit e pasurive të paluajtshme).

Pika e dytë përfshin trajtimin sistematik, që do të thotë se proceset e ndryshme të lidhura me pronën (legalizimi, azhurnimi, trajtimi i pronës, regjistrim AMTP-je, inventarizimi i pronave shtetërore) do të konceptohen dhe do të zbatohen në mënyrë të njëkohshme dhe sistematike, pra jo më në mënyrë të çrregullt.

Pika e tretë përfshin proaktivitetin që lidhet me rolin e shtetit, i cili për çështjet që kanë të bëjnë me pronën duhet të marrë efektivisht rolin e rregullatorit dhe jo më atë të vrojtuesit dhe konstatuesit të thjeshtë të problematikave.

Pika e katërt përfshin unifikimin e bazës hartografike dhe dixhitalizimin, që lidhet me funksionimin e të gjitha proceseve që kanë të bëjnë me pasuritë e paluajtshme, çka përbën, gjithashtu, një nga kushtet themelore për të mundësuar realizimin e reformës.

Dixhitalizimi i sistemit të pasurive të paluajtshme, si dhe i të gjitha proceseve të tjera administrative të lidhura me pronësinë. Ndërhyrja e reformës do të prekë proceset kryesore si vijon: mbylljen e proceseve transitore të pronësisë, përfshirë regjistrimin fillestar të pronarëve ligjorë sipas AMTP-ve (leje legalizimi, vendimeve për trajtimin e pronës dhe pronarëve faktikë); procesin, përmirësimin dhe përditësimin e zonave kadastrale, meqenëse informacioni i regjistruar për pjesën më të madhe të tyre është totalisht në gjendje manuale, i papërmirësuar, i papërditësuar, kjo për një periudhë 20-vjeçare, pavarësisht karakterit dinamik që ka vetë prona, si dhe vijimin e proceseve të gjata, duke siguruar dhe garantuar një regjistër të plotë dhe të saktë të të dhënave të pasurive të paluajtshme dhe sipas standardeve.

Ndërveprimi i drejtpërdrejtë së brendshmi ndërmjet institucioneve që prodhojnë akte pronësie, si: ATP, ALUIZNI, institucionet e AMTP-ve dhe AITTP-ve, si dhe institucionit që regjistron dhe arkivon aktet e pronësisë, si destinacion final.

Riorganizimi i institucioneve të pronësisë do të kryhet duke u bazuar në mirintegrimin e secilit prej këtyre proceseve, sot i ndarë në katër institucione, pra do të bëhet unifikimi i një institucioni të vetëm, i quajtur Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Në përmbajtje të institucionit të ri do të operojnë departamente të veçanta, duke u mundësuar atyre autonomi të brendshme, si dhe do të synojnë të organizohen sipas funksioneve prioritare për kryerjen e proceseve transitore ku përfshihen: regjistrimi fillestar, përmirësimi, përditësimi i ndërtimeve pa leje.

Reforma institucionale parashikon të krijojë një platformë të dedikuar, pra një strukturë të posaçme apelimi, për trajtimin e ankesave të qytetarëve, me qëllim përmirësimin e shërbimit fundor të qytetarët, por edhe përmirësimin e proceseve dhe funksioneve të vetë institucionit.

Ky reformim strukturor garanton një koordinim më të mirë nëpërmjet proceseve të veçanta, çka është karakteristikë e sistemeve të centralizuara, dhe me këtë formë organizimi zgjidhet një problem themelor, ai në të cilin organet shtetërore që lëshojnë tituj pronësie

konkurrojnë në trajtimin e së njëjtës pronë me procedura të veçanta, me subjekte të ndryshme dhe pa bashkërenditur informacionin.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Faleminderit, zonja Zëvendësministre!

Zoti Lame, edhe nga përbërja e grupit, e pamë se ka qenë një komponent i rëndësishëm i diskutimit të ligjeve.

Zonja Vodo e përmendi boshtin kryesor të ndryshimeve ligjore. Pra, kemi një kuadër institucional të ri, kemi një institucion të ri. Lajmi i mirë është që të gjitha ato ping-pongjet institucionale, lëshet institucionale do të thosha, tashmë do të jenë nën një ombrellë. Më konkretisht, duke e filluar me arsyet pse po vijmë te ndryshime të tilla ligjore dhe çfarë synohet.

Do të thosha se lajm i mirë është dixhitalizimi i sistemit ose unifikimi i bazës hartografike.

Fjala është për ju, zoti Lame.

Artan Lame – Faleminderit!

Ju thatë se nuk jeni komision përgjegjës, por unë do të thosha që në këtë komision jam ndier komod sa herë kemi pasur qoftë diskutime për ndryshimet ligjore të deritanishme, qoftë për raportimet e herëpashershme dhe realisht jam ndier ndërmjet miqsh. Madje edhe kur bëhej fjalë për palë politike, është diskutuar gjithmonë lirshëm dhe ka qenë pjesa më e mirë, sepse të gjithë e kanë kuptuar përgjegjshmërinë dhe rëndësinë e këtyre proceseve.

Të vijmë tani te problematika aktuale.

Natyrisht, duke më njohur, nuk mund të pretendoni që unë të flas për të sotmen pa bërë dy fjalë histori. Ndaj, do të thosha se nga pikëpamja historike, reforma që po ndërmerr Kuvendi është reforma e pestë në historinë e shtetit shqiptar, duke filluar nga viti 1912, për të drejtën e pronës, duke konsideruar si reformë të parë kalimin nga Perandoria Osmane në shtetin shqiptar.

E dyta është vetë reforma që u mundua të bënte shteti shqiptar në periudhën 1912-1944.

E treta është përmbysja e madhe pas vitit 1944, që ndryshoi komplet logjikën pronësore të vendit me një logjikë të caktuar.

Reforma e katërt ka qenë përmbysja tjetër e madhe e vitit '90, kur sërish ndryshojnë marrëdhëniet me pronën, për të ardhur në ditët e sotme kur duhet të ndahemi përfundimisht nga periudha e tranzicionit në raport me pronën dhe mbylljen e periudhës të shtetit pronar që

ndan prona dhe kalimin në periudhën e shtetit administrator dhe mbrojtës të së drejtës së pronës midis qytetarëve.

Ajo që ka ndodhur në këto gati 30 vjetët e fundit, për fat të keq, ka qenë një copëzim i një morie procesesh, të cilat asnjëherë nuk ka qenë e mundur të mbyllen. Natyrisht që mund të gjejmë fajtorë sa të duam pse u bë kështu ligji nr. 7501, pse u bë në atë formë privatizimi apo pse u bë privatizimi i banesave në atë mënyrë apo në këtë mënyrë, por nuk mund të kërkojmë më tepër se aq në nivelin kulturor dhe vizionar të shqiptarëve të viteve '90. Shumë reforma që u filluan në atë kohë mbetën rrugës ose u devijuan në vite, dhe, si rezultat, reforma apo lëvizje që duhet të fillonin dhe të mbaronin si të përkohshme, u kthyen në të përhershme. Në qoftë se e filluam ligjin nr. 7501 në vitin '91 për t'u ndarë tokën fshatarëve, ai proces duhet të mbaronte brenda 2-3 vjetëve. Jemi në vitin 2018 dhe akoma bëhet ndarje e tokës dhe pajisje me tituj pronësie në fshat. Është jashtë çdo imagjinate që pas 27 vjetësh akoma ndajmë toka të kooperativave apo fermave bujqësore që janë prishur para 27 vjetëve.

Edhe procesi i kthimit dhe i kompensimit të pronave që filloi në vitin 1993, duhet të kishte përfunduar brenda 2-3 vjetëve, siç ndodhi në të gjithë Lindjen ish-komuniste. Jemi në vitin 2018 dhe jemi ndoshta në mes të këtij procesi, sepse nuk e dimë akoma sa kohë do të zgjasë procesi i kthimit dhe i kompensimit të pronave apo procesi i privatizimeve i filluar në vitin 91, ku akoma vazhdojnë privatizimet nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë. Edhe ky proces duhet të ishte mbyllur brenda disa viteve.

Po përmend vetëm proceset kryesore në këtë varg procesesh të privatizimit të ekonomisë.

Procesin e legalizimeve, i filluar me ligj nga qeveria "Nano" në vitin 2004, akoma pas 14 vjetëve nuk e kemi mbyllur. Edhe ai duhet të mbyllet brenda 2-3 vjetëve. Ligje legalizimi ka bërë e gjithë bota dhe vazhdon të bëjë, por janë procese që i hapin dhe i mbyllin brenda 3-4 vjetëve dhe jo të zvarritura kaq në kohë. Thelbi i të gjitha këtyre proceseve që unë përmenda ka qenë procese të përkohshme, të cilat janë kthyer në procese të përhershme, sepse kanë mbi 25 vjet që vijojnë.

Në këtë kuadër, legjislacioni i ri i përmbledh të gjitha këto procese në një ligj të vetëm të quajtur "Për përfundimin e proceseve tranzitore të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Pra, këto procese të përkohshme tranzitore pronësimi përmbyllen me këtë ligj. Natyrisht, nuk përmbyllen në një ditë të gjithë, pra, ka midis tyre procese që do të përmbyllen më shpejt dhe të tjerë që do të përmbyllen më pas, por ama do të përmbyllen njëherë e mirë proceset e pronësimi në Shqipëri. Shteti përfundimisht mbyll kapitujt e pronës së vetë dhe

prona kthehet në një element zhvillimi, i cili transferohet nga njëri te tjetri jo më si dhuratë e shtetit, por thjesht si marrëdhënie ekonomike kapitaliste si në çdo vend normal të këtij sistemi. Ndoshta në të ardhmen mund të shpikim ndonjë sistem tjetër, por ky sistem njihet vetëm transferimin e pronës në rrugë të ligjshme nëpërmjet blerjes, shitjes e kështu me radhë, e cila do të vazhdojë jetë e mot. Të gjitha proceset e tjera duhet të mbyllen.

Këtë synon ligji kryesor, i shoqëruar me ligjin për kadastrën në Republikën e Shqipërisë, i cili zëvendëson në një farë mënyre ligjin e sotëm për Zyrën e Regjistrimeve të Paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, i cili është ndryshuar disa herë. Nuk jam i prirur t'i vë faj askujt në këto 25 vjet, sepse ky ka qenë niveli zhvillimor i vendit. Të mos harrojmë që në fushën e kadastrës dhe të drejtës së pronës kemi pasur handikapi gati 50 vjeçar, ku praktikisht nuk ekzistonte, për të mos thënë që ishte e panevojshme, regjistrimi i pronave, sepse nuk kishin më pronë. Pra, procesin e kadastrës e rikrijua pas '90-s, natyrisht me problemet që barti deri më sot, që e shikojmë të domosdoshme reformimin themeltar të sektorit.

Do të doja të bëja një përmbledhje të problematikës me të cilën do të merret ligji "Për proceset tranzitore në Republikën e Shqipërisë" për të kuptuar të gjithë bashkë se sa e rëndë është situatë pronësore në vend dhe se nuk mund të vazhdohet më me kaosin institucional, që përmendi edhe zoti Shalsi, të një morie institucionesh që në mënyrën e tyre trajtojnë pronën, por më shumë krijojnë shtresa dhe mbishtresa kaosi brenda territorit të vendit. Po flasim për një vend që është shumë i vogël për të pasur problematika kaq të komplikuar. Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Bujqësisë, e cila dha shumë kontribut, me Ministrinë e Ekonomisë, që iu morën të dhëna për të krijuar, për herë të parë krijuam një panoramë të peshës së problemeve, një tabelë që ishte shumë e pasaktë në fillim, por që kohë pas kohe e rifreskuam dhe besoj se do të vazhdojmë ta rifreskojmë edhe në të ardhmen.

Procesi i regjistrimit fillestar të pasurive të paluajtshme ka filluar në vitin 1994 me ligjin e parë për regjistrimin e pasurive. Shqipëria rezulton me rreth 4,4 milionë pasuri të paluajtshme, nga të cilat rreth 3,8 milionë janë regjistruar dhe rreth 600 mijë pasuri të tjera janë të paregjistruara ende. Në pikëpamje të parë duket sikur është bërë goxha punë dhe është bërë në fakt, por kur i futemi në themel rezulton që rreth 2,5 milionë e pasurive të regjistruara janë me probleme. Kjo do të thotë se minimalisht duhen përmirësuar dhe maksimalisht duhen bërë nga fillimi. Nga viti '94 deri tani shteti shqiptar ka harxhuar rreth 80 milionë euro dhe dollarë në këtë proces, të cilat më shumë kanë krijuar kaos sesa kanë zgjidhur punë. Për

shkak se në 3,8 milionë pasuri të regjistruara, paratë e harxhuara për 2,5 milionë më shumë janë të deformuara dhe duhen rishikuar. Kjo çon në morinë e pafundme të gjyqeve ku qytetarët e kanë të regjistruar dhe dalin që e kanë pronën me mbivendosje, të deformuar apo spostuar. Kjo pikërisht për shkak të gjithë këtij procesi 24 vjeçar të regjistrimit të pronës, i cili ka qenë shumë defektoz.

Me kënaqësi do të bëja një analizë pse ka qenë kaq defektoz, por kam frikë se do të humbisja në hollësi. Fakti është që, sot , nga 4,4 milionë pasuri, 3,8 milionë janë të regjistruara dhe nga këto 2,5 milionë janë me probleme. Procesi i Trajtimit dhe i Kompensimit të Pronës i filluar në vitin 1993.

Për shkak se ne u lajmëruam pak vonë dhe, unë nuk pata mundësi sot t'ju bëja një tabelë që t'ia lija secilit prej jush, sepse është punë e bërë nga një grup njerëzish, e cila jep tregun një panoramë të të gjithë peshës së problemit. Nga 47 mijë praktika që ka pasur në të gjitha kohët Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, deri tani janë marrë 26 mijë vendime dhe 18 mijë janë rivlerësuar edhe me ligjin e ri. Aktualisht mund të jenë rreth 8 mijë praktika ende të patrajtuara që nga viti 1993, jo më të ritrajtuara me ligjin e ri dhe të kompensuara dhe të mbyllura përfundimisht.

Është fjala për procesin e pajisjes me AMTP, pra, akti i marrjes së tokës fillimisht në përdorim dhe më pas në pronësi. Me procesin e ligjit nr. 7501 kanë përfituar rreth 438 mijë familje fshatare, nga të cilat rreth gjysma janë ende të paregjistruara në ZVRPP në kadastër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të dyja bashkë. Kooperativat bujqësore dhe ndërmarrjet bujqësore.

Shifër të saktë për këtë nuk ka askush. Sa prej tyre janë regjistruar në ZVRPP? Për shkak të vetë strukturës së ZVRPP-së, që nuk e ka të informatizuar të gjithë sistemin, nuk mund të merret informacioni, megjithëse u punua gjatë dhe u arrit që gjysma janë të regjistruar dhe gjysma tjetër të paregjistruara në ZVRPP. Pra, kanë aktin e marrjes së tokës në shtëpi, por nuk e kanë të regjistruar në ZVRPP. Aktualisht ky është një nga problemet më vrapshëm të tokës në fshat, që bllokun të gjitha proceset e tjera, të shit-blerjes midis vetë fshatarëve, të përfitimit të kredive apo incentivave nga Ministria e Bujqësisë e kështu me radhë.

Kjo për shkak se nuk janë në gjendje të demonstrojnë ligjërisht që janë pronarë të tokës. Përveç këtyre, janë rreth 20 mijë familje (kanë rënë pak për shkak të impenjimit të qeverisë vitin e fundit nëpërmjet Ministrisë së Bujqësisë për ta mbyllur si proces), që nuk

janë pajisur ende me AMTP, pra, hallkën e parë, për të shkuar më pas te regjistrimi. Procesi i verifikimit të AMTP-ve ka filluar në vitin 2009. Ndoshta qeveria në atë kohë mund ta ketë pasur me sens pozitiv, por pastaj degradoi rrugës si proces. Ishte procesi që ngarkoi prefekturat për të verifikuar titujt e dhënë për shkak se realisht ishte bërë problem abuzimi me AMTP-të. Në qoftë se filluam në vitin 1991 të ndanim tokën, 5-6 vjetët e para ndarja e tokës ishte reale, por pas asaj periudhe degradoi thjesht në çfarë ka mbetur pa ndarë, mbledhje komisioni dhe e ndante në fshat, çfarë ka mbetur në bregdet, ndonjë pyll apo ranishte, e ndanin, proces në masën kryesore të tij abuziv, por nga pikëpamja formale ligjore nuk mund të ndalej ose nuk deshën ta ndalnin asnjëherë.

Në vitin 2009 u mor një nismë për të bërë verifikimin e këtyre titujve të marrë, por praktikisht edhe ajo degjeneroi dhe nuk dha rezultate pozitive. Si proces është ende në këmbë.

Procesi i transferimit të pronës te njësitë vendore ka filluar në vitin 2002 me një agjenci të ngritur për këtë çështje. Në Shqipëri për herë të parë ndodhte që njësitë vendore të merrnin prona në administrim dhe më pas në pronësi. Për fat të keq është në nivelet gati zero, që do të thotë se janë regjistruar deri më sot afërsisht 4% e pronës te njësitë vendore. Me lista është transferuar shumë, kurse me regjistrim në ZVRPP është akoma në nivelin e rreth 4%. Do të thotë, njësitë vendore dhe bashkitë kanë marrë lista pronash pa fund nëpërmjet qeverive në të gjithë këta vjet që nga viti 2002, por nuk i kanë të regjistruara. Kjo bën që praktikisht jua bën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... përbashkët. T'i them edhe arsyt pse kanë faj edhe njësitë vendore edhe shteti. Nuk i kanë regjistruar dhe kjo bën që e kanë gati të pamundur t'i përdorin. Kur duhet patjetër të përdorin një pronë fillojnë vijnë vërdallë si do të bëjnë regjistrimin e tyre. Avancimi si proces është i domosdoshëm, sepse nëse ka arsye që ka paralizuar në shumë raste njësitë vendore në përdorimin e pronës së tyre ka qenë pikërisht paaftësia dhe pamundësia për ta regjistruar pronën në ZRPP.

Një proces tjetër është procesi i regjistrimit të pronës shtet. Vetë shteti shqiptar nuk e ka të regjistruar pronën e vet në ZRPP.

Në një farë mënyre, ZRPP-ja, apo kadastra është godina më e rëndësishme në një shtet modern. Mund të bjerë çdo gjë, por humbja e kadastrës e kthen shtetin në nivelin zero. Mendoni pastaj një shtet që nuk i ka regjistruar akoma pronat e veta në të gjitha këto vite. Mjafton t'ju them, se na u desh një punë 4-vjeçare dhe vetëm para 2 muajsh ne arritëm të

regjistrionim godinën e ALUIZN-it. Kjo jo se kishte faj ZRPP-ja në rastin konkret, por sepse meqë toka aty ishte me një pronar të vjetër, ai kishte bërë dokumentet, duke e fshirë fare nga kadastra godinën, për t'i hapur rrugë kthimit të pronës. Prandaj, na u desh të hapnim arkivat e vjetra të ndërtimit për të demonstruar që godina ekzistonte, godina ishte aty, por nuk ekzistonte me letra. Më vonë iu hap rrugë regjistrimit të saj.

Imagjinoni që këtë problem e kanë të gjitha dikasteret në vend dhe përveç godinës qendrore, për të gjitha godinat në territor. Pak më përpara në këtë kuadër është Ministria e Mbrojtjes, por kjo vetëm për arsye të presionit pozitiv të NATO-s, që ka kërkuar ndarjen e pronave që do të mbajë përfundimisht Ministria e Mbrojtjes, ato që quhen plani i përhapjes dhe regjistrimin e tyre. Edhe ata kanë mundur të bëjnë listimin e tyre, por jo regjistrimin e saktë dhe përfundimtar në ZRPP, sepse në shumë raste e kanë në letër, por atje nuk ekziston asgjë, rezulton ose si kullotë për bagëtinë, ose tokë e zënë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Godina e ALUIZNI-t ka qenë më parë Instituti i Perimeve-Patateve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka kërkuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është godinë e viteve '70.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është regjistruar para 1 muaji. Herën që vjen, do t'ju sjell certifikatën e pronësisë. Bëmë për 4 vjet luftë pozitive për të demonstruar që ekziston objekti, se e kishin zhdukur në letra.

Këtë presion e bëmë, sepse nëse kërkojmë nga të tjerët regjistrimin e pasurive shtetërore, nuk mund ta linim pa regjistruar më parë godinën e ALUIZN-it. Ky mbetet një nga problemet e mëdha të administratës shtetërore.

Edhe një herë ju tërheq vëmendjen në këtë çështje, sepse nëse ka arsye që oborret e shkollave dhe të kopshteve dhe të institucioneve publike janë zënë dhe në ndonjë rast, edhe janë legalizuar, në shumë raste të tjera, janë privatizuar apo janë kthyer si prona, kjo ka ndodhur vetëm, sepse kanë qenë të paregjistruara. Për sa kohë që shkolla është pronë shtet, çdo institucion fut dorën dhe e shqyen, mundohet të kapë diçka.

Shkolla duhet të regjistrohet, si shkollë, si territor shkolle në ZRPP në emër të Ministrisë së Arsimit, nëse e ka kjo ministri apo në emër të njësisë vendore, nëse ka kaluar në

emër të njësisë vendore. Pra, duhet të marrë fund historia e pronës shtet. Pra, e gjithë Shqipëria noton në një pronë shtet, që është e askujt.

Do të jenë një nga pikat themeltare vënia në punë e institucioneve shtetërore që të regjistrojnë pronën e tyre, atë pronë që kanë vendosur që do ta mbajnë përgjithmonë.

Shteti shqiptar përgjithësisht ka të regjistruara në ZRPP vetëm ato, që na ka lënë të regjistruara Naltmadhnia. Kjo do të thotë se kryeministria dhe ministritë janë të regjistruara, sepse i ka lënë të regjistruara Naltmadhnia atëherë, përndryshe edhe ato do të ishin vetëm pronë shtet. Kjo është situata në lidhje me regjistrimin e pronës shtet.

Procesi i legalizimeve i filluar në vitin 2004, vijon ende. Edhe këtu shifrat duhen ndryshuar, sepse kur është hartuar tabela kanë qenë 150 objekte të legalizuara, ndërsa tani jemi 165 mijë objekte të legalizuara dhe në 227 mijë objekte të legalizueshme. Pjesa e mbetur (rreth 60 mijë objekte), do të vazhdojë dhe, me këto ritme brenda 2 vjetëve, do të përfundojë procesi i legalizimit.

Kalimi në pronësi i oborreve në përdorim.

Janë edhe disa procese transferimi prone të mbetura varur nga kohë të ndryshme, që nuk janë mbyllur asnjëherë. Kjo do të thotë: para disa muajsh qeveria miratoi VKM-në nr. 442 për regjistrimin e banesave para vitit 1991. Pra, është i gjithë stoku i banesave të ndërtuara para vitit 1991, janë të paregjistruara në kadastër. Kjo e bën të pamundur transferimin e pronave e të tjera me radhë. Kjo krijon strese të jashtëzakonshme, sidomos, kur ka shpronësime për interes publik. Në qoftë se sot një pjesë e banorëve të Shkozës janë në protestë, arsyeja është sepse shteti shqiptar ka qenë i paaftë që nga viti 1995, që ka filluar si proces, të përfundojë regjistrimin e shtëpive të para vitit 1991.

Sot është e martë dhe besoj se nesër del stoku i parë i këtyre banesave të Shkozës, që regjistrohen. Procesi ka filluar që në korrik me VKM-në nr. 442. Deri tani jemi marrë me procedurat dhe regjistrimi i tyre përfundon nesër, në mos gaboj sepse i kemi ndjekur hap pas hapi. Ata do të marrin certifikatën e pronësisë, gjë që u bën të mundur të hyjnë në proces shpronësimi për interes publik. Ky stok rezulton të jetë aktualisht rreth 20-40 mijë familje. Askush nuk e di se sa janë, sepse është një proces që po bëhet me investimin e vetë qytetarëve. Te ndërtimet para vitit 1991 nuk përfshihen vetëm ndërtimet e kohës së Enverit. Mjafton t'ju them se pjesa më e madhe e Gjirokastrës historike dhe ajo Beratit historik janë të paregjistruara. Edhe në lagjet e vjetra të Korçës është e njëjta situatë. Pra, ato nuk janë regjistruar asnjëherë në ZRPP. Përveç kësaj, shumica e ndërtimeve ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë një kategori më mbrapa.

Ju lutem?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ato kanë akte të vjetra, të cilat janë të pavlefshme, të patransferueshme në ZRPP-në e sotme.

Realisht, përtej fjalëve, po kthehem edhe një herë më pas në kohë. Mbreti Zog filloi në vitet '30 një proces regjistrimi të pasurive të paluajtshme. Ajo ishte një reformë shumë e madhe dhe shumë europiane. Në një moment të caktuar ai u lodh dhe e braktisi atë. Nuk po i hyj analizës historike pse ndodhi kështu. Kjo krijoi më pas kaos.

Një nga elementet e asaj reforme ishte lënia e një fati 3-vjeçar që të gjitha hipotekat e kohës së Turqisë, që ishin me harta turke, të ktheheshin dhe të regjistroheshin me dokumente të shkruara në latinisht në hipotekën e atëhershme. Pas atij afati nuk të njihej më pronësia, nëse ti shkoje me letrat në turqisht.

Hapi ishte shumë pozitiv, sepse duhej hequr dorë nga shkresat turke. Vetë turqit kishin hequr dorë nga këto shkresa, ndërsa ne nuk kishim hequr dorë ende. Hapi i hedhur ishte shumë pozitiv. Filloi pozitivisht, degradoi rrugës, derisa e braktisi fare, por nga pikëpamja ligjore të gjitha letrat në turqisht sot janë teorikisht të pavlefshme. Në gjykimin tim personal, s'dua të më merret si akuzë ndaj komisioneve të kthimit të pronave ndër vite, por të gjitha dokumentet në turqisht të përdorura për kthimin dhe kompensimin e pronave janë abuzim, sepse një ligj i shtetit shqiptar në vitin 1932, i quajti të pavlefshme pas 3 vjetësh. Praktikisht, nuk duhej të hapeshin më.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk duhej të njiheshin fare, zero, sepse ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, pra. Pastaj hymë te gjyqet e faktit, që ishte një nga proceset më degjenerative.

Të kthehemi aty ku ishim. Edhe një pjesë e madhe e banesave të para vitit 1991, janë të paregjistruara në kadastër. E njëjta situatë është edhe në fshat. Në një pjesë të madhe të fshatrave pasuritë janë të paregjistruara. E dimë të gjithë, se kemi njerëz në fshat, që i kanë shtëpitë të paregjistruara.

Ky proces ka filluar në vitin 1995 dhe nuk është mbyllur ende.

Proces tjetër i njohjes së pronësisë i lënë në mes, është ai i oborreve në përdorim. Para vitit 1990 ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, ajo është ana...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të jepte të drejtën për të ndërtuar, zakonisht të jepte parcelën, por nuk ta jepte me letra, nuk merrej dokument pronësie për parcelën. Bëhej banesa mbi të dhe ka zënë 100 metra me banesën dhe 200 metra i ka pa letra. Pra, edhe kur kanë banesën e regjistruar, nuk kanë të regjistruar tokën. Është një proces për oborret në përdorim, edhe ky i nisur, por i pabitisur asnjëherë. Përveç këtyre proceseve, janë edhe disa mikroprocese të tjera në privatizimin e godinave shtetërore, sepse janë privatizuar godinat, por asnjëherë nuk është privatizuar trualli. Pra, janë të gjitha këto ferra të vogla, të cilat kanë krijuar këtë situatë të ngecjes së ekonomisë. Këto ferrat e mëdha dhe ferrat e vogla kanë krijuar këtë frenim dhe ngecje të ekonomisë për shkak të këtyre proceseve të pambyllura asnjëherë. Ky është thelbi i ligjit që po paraqesim, pra përmbyllja e proceseve transitore, sepse të gjitha këto janë procese transitore pronësie.

Kjo ishte panorama e përgjithshme e situatës.

Eduard Shalsi – Kam dy pyetje shumë të shkurta.

E para, do ta ketë nevojë për akte nënligjore, por sa është numri i tyre dhe sa është periudha e përgatitjes dhe e miratimit të tyre?

E dyta, thamë që do të bashkojmë 4 institucione në 1, suktesi i kësaj reforme do të jetë te ndërtimi i institucionit të ri, sa kohë do të duhet që të ndërtohet një institucion i ri që të fillojë të funksionojë e të bëhet efektiv e eficient?

Mbaji shënim pyetjet dhe më pas përgjigju të gjithave.

Ne si komision kemi bërë vazhdimisht vizita në institucione të ndryshme të pavarura, ose në agjenci shtetërore dhe kemi konstatuar shpeshherë një mangësi nga pikëpamja e mjediseve të punës, të cilat janë krejtësisht të papërshtatshme për të ushtruar detyrat dhe përgjegjësitë; mungesë të sistemeve, ndërkohë që është koha e teknologjisë së informacionit, e cila të lejon të bësh analiza më të detajuara që lejojnë edhe një vendimmarrje sa më të saktë, por që përdoren më pak; e treta, kapacitet njerëzor, pra logjistika e institucioneve dhe kapacitetet njerëzore, të cilat për sfida të tilla kanë nevojë të ndërtohet me shumë kujdes dhe të mbahen vazhdimisht të trajnuara.

Sfidë e këtij institucioni të madh do të jetë administrimi i bazës së të dhënave fillimisht për të ndërtuar sistemin e ri. Pra, periudha transitore e ndërtimit të institucionit të ri sa parashikohet të zgjasë? Po ju sjell një shembull, sepse nuk mund ta fsheh kënaqësinë e vizitës tek OSHEE-ja, një godinë dinjitoze, me mjedise pune krejtësisht moderne, të pajisura

me një logjistikë dhe me një sistem që po azhurnohej, ku kënaqeshe duke parë një ambient i cili mund të sjellë produkt. Ndërkohë, kemi shkuar edhe në institucione të tjera dhe mjafton t'i shohësh 5 minuta se ku punojnë, si punojnë dhe kush punon për të krijuar opinionin për to. Modernizimi i institucionit duhet të jetë një nga sfidat.

Zoti Baraj, pastaj zonja Gjermani.

Besnik Baraj – Pyetja që do të bëj unë është në vazhdim të atyre pyetjeve që bëri zoti Shalsi. Ju folët për një nisje procesesh dhe vazhdimin në pafundësi. Që ky projektligj të mos rrijë nderë, a keni bërë një parashikim se cili është intervali kohor që ju keni parashikuar për dixhitalizimin dhe përfundimin e gjithë kësaj ambicieje që keni ju dhe a keni parashikuar ju burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare që t'ia bëni prezente qeverisë, në mënyrë që t'i realizoni këto?

Pyetja e dytë është e lidhur me një ngjarje aktuale, pra me Unazën e Re, në njolla, atje ku ka projekte qeveria (dhe ka ndodhur që projektet janë në qeveritë konsektive, pra edhe paraardhëse) janë bërë legalizime selektive. A mendoni ju se personat e administratës shtetërore që kanë bërë këto legalizime mbajnë përgjegjësi ligjore? Shpesh indinjata e njerëzve vjen kur ka selektivitet. Bëhet e imja, por nuk bëhet e zotit Suli, ndërkohë që jemi fqinj. Kjo i revolton më shumë njerëzit.

Eduard Shalsi – Po, zonja Gjermani.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, kryetar!

Unë doja të falënderoja zëvendësministren, zotin Lame dhe të gjithë grupin e punës që ka punuar për këto dy projektligje shumë të rëndësishme, të cilat jo vetëm formojnë dhe përmirësojnë kuadrin ligjor të pasurive të paluajtshme në Shqipëri, por krijojnë edhe institucionet përkatëse për të adresuar të gjitha problematikat e pronës!

Ligjet, në fakt, janë shumë ambicioze dhe mundohen të përmbushin angazhimin madhor të qeverisë për të adresuar çështjen e pronave në një mënyrë të qenësishme dhe afatgjatë. Për këtë gjë duhen përgëzuar, sepse ishin, siç tha kryetari, të shumëpritura, për më tepër që synojnë të krijojnë një sistem të konsoliduar të pasurive apo të sistemit të pronësisë në Shqipëri.

Dua të them dy fjalë edhe si relatore. Për t'u vlerësuar është edhe eliminimi i hallkave burokratike, sidomos ndërveprimi institucional. Ju e përmendët kaosin institucional, por besoj ne me zotin Lame kemi përvojën që jepnim lejet e legalizimit, pastaj nuk merrej hipoteka apo kishte probleme të tjera, të cilat i sorollatnin qytetarët për një kohë të gjatë. Kështu që uroj dhe shpresoj shumë që nëpërmjet të dy projektligjeve të adresohen problemet

më të mprehta edhe nëpërmjet një sistemi të konsoliduar të pronësisë, pra nëpërmjet dixhitalizimit qytetarët të kenë më shumë akses dhe më shumë mundësi që të marrin atë që u takon pa sorollatje burokratike.

Pa dyshim zgjidhet njëherë e mirë problemi i pronave, çështjet sociale të mprehta që lidhen me çështjet e pronave, si dhe hapet një mundësi e re për rritjen e investimeve në Shqipëri. Një nga arsyet që nuk kemi pasur investime të huaja ka qenë edhe problemi i pronësisë, që është një problem i madh.

Në fakt, përveç vlerësimeve, kam edhe një sërë pyetjesh, dhe nuk po i ripërsërit risitë, meqenëse folët në detaje. Për të dyja projektligjet, të cilët na kanë ardhur dje, pra është një kohë shumë e shkurtër, dhe i kërkoj kryetarit të kemi pak më shumë kohë edhe për ta diskutuar, sepse sot vetëm prezantohen, kam disa çështje, për të cilat dua më shumë sqarim.

E para, projektligji "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë" që nga titulli synon të adresojë gjitha problematikat e mbetura në 20 e ca vjet dhe duhet përshëndetur e vlerësuar në mënyrë të veçantë. Nga një sy që i hodha, më është krijuar përshtypja se është ngritur në bazë të problematikave që ju keni hasur në realitet.

Ne në zonat tona elektorale kemi parë probleme të larmishme dhe kaq të ndryshme nga njëri-tjetri, të cilat është e vështirë t'i adresosh me një ligj. Kështu, dua t'ju bëj pyetjen: vërtet më anë të këtij projektligji synojmë ta mbyllim njëherë e mirë këtë proces problematik të pronave dhe a arrijmë dot t'i adresojmë thuajse të gjitha problemet?

E dyta, në relacionet e të dyja projektligjeve nuk ka asnjë informacion lidhur me konsultimet e grupeve të interesit. Ju keni punuar si grup ndërinstitutional pune për gati një vit, a jeni konsultuar me grupet e interesit? Cilat kanë qenë mendimet, sugjerimet e tyre dhe a janë marrë në konsideratë, apo jo? A i shikojnë të dyja projektligjet si zgjidhje?

Çështja tjetër lidhet me kapacitetet institucionale, jo vetëm me ato financiare, e tha kolegu Baraj. Unë lexova në relacion se për sa i përket buxhetit ju do të keni buxhetet e parashikuara për institucionet që bashkohen për vitin tjetër, pavarësisht se krijohet një institucion i ri, siç është Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila duhet të përgëzohet patjetër dhe besoj se është mirëpritur nga të gjithë qytetarët, por si do të funksionojë në kuptimin që të bashkojë tri buxhete të tri institucioneve, sa kohë duhet për ta bërë që të funksionojë realisht këtë institucion?

Kam edhe një pyetje tjetër lidhur me hyrjen në fuqi, sepse në fund të projektligjit thuhet se hyn në fuqi më 31 janar 2019, ndërkohë që kemi për ta kaluar në seancë brenda

muajit dhjetor, pra duhet të impenjohemi maksimalisht që të diskutojmë dhe ta miratojmë së shpejti. A ka ndonjë arsye specifike që duhet të hyjë patjetër në fuqi më 31 janar?

Pyetje tjetër: çfarë do të bëhet me ligjin nr. 7501? Çfarë do të ndodhë më ato toka që nuk janë azhurnuar? Mbase këto mund t'i diskutojmë edhe nen për nen, por u mundova t'i përmbledh të gjitha shkurt.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Zoti Suli.

Rakip Suli – Faleminderit, zoti kryetar!

Pavarësisht se relatorja i preku gjërat më kryesore të këtij projektligji, unë kam dy pyetje. Në radhë të parë dua të bëj një falënderim për ardhjen e këtij projektligji, sado vonë, por më mirë vonë se kurrë, sepse, duke u zgjidhur problemet e pronës, zgjidhen shumë çështje dhe shumë probleme në këtë vend.

Dua të di nëse me bashkimin e katër institucioneve, do të reduktohet numri i punonjësve, apo do të jetë të njëjtët persona që janë aktualisht?

E dyta, e bënë kryetari dhe zonja Gjermani pyetjen për kohën reale të fillimit të punës së këtij institucioni, unë kam një pyetje tjetër rreth kësaj. Gjatë diskutimit që bëtë, thatë se janë 4,4 milionë pasuri në total, rreth 3,8 milionë të regjistruara, 600 mijë të paregjistruara dhe 2,5 milionë me probleme, nëse sot tre muaj ky institucion do të fillojë punën reale, edhe sa vite do të duhen që të marrë fund i gjithë procesi? Normalisht, sot jemi brenda një shteti dhe kemi disa institucione, legalizimet dhe hipotekat. Unë si deputet përfaqësoj Kamzën dhe Paskquanin, zonat me më shumë legalizime, ku një pjesë e madhe kanë marrë legalizimet, por nuk marrin dot hipotekat, dua të them se me këtë projektligj, edhe nëse vonohet për pak kohë për miratim, është më mirë, sepse bëhet njëherë e mirë dhe ky problem do të marrë rrugëzgjidhje.

Faleminderit!

Eduard Shalsi – Vazhdojmë me përgjigjet e pyetjeve që të mos grumbullohen shumë. Janë disa pyetje të përbashkëta që kemi bërë ne, të cilat mund t'i bashkosh.

Artan Lame – Faleminderit!

U përmend nga zoti Shalsi dhe nga kolegët e tjerë çështja e bashkimit të institucioneve, i cili është mjet dhe nuk është qëllim. Këtë reformë të madhe e kemi parë vazhdimisht si përmbyllje të proceseve transitore për bërjen e një kadastre serioze. Këto institucione do të bashkohen në një, pastaj do të bëhet rifreskimi i të gjitha lejeve të pronësisë në vend. Boshti i këtij bashkimi institucional nuk është ALUIZNI, por është kadastra. ZRPP-

ja është strumbullari i këtij mullari, ku do të vëmë të gjitha lejet e ndryshme hartografike të vendit, madje jo vetëm këto, por edhe lejet e tjera hartografike, për të cilat ka nevojë vendi. Sistemi i adresarit ka nevojë për një hartë të vetën, sepse sot ata janë të detyruar të bëjnë një hartë të tyre, pasi nuk mbështeten dot te lejet e ZRPP-së, të cilat janë një problematikë e madhe. Kadastra fiskale ka ndërmend të bëjë një hartë të veten të vendit, sepse nuk mbështetet dot te harta e ZRPP-së, e cila ka probleme. Edhe agjencitë e tjera të vendit kanë nevojë për hartografi, sepse ata nuk përdorin dot hartografinë ekzistuese, pasi ka probleme. Pra, boshti i këtij bashkimi është ZRPP-ja dhe të gjitha të tjerat i bashkohen, sepse janë procese të përkohshme, të cilat me kohë, njëri pas tjetrit, do të shuhen. Procesi i parë që do të shuhet është ai i legalizimeve, pastaj i banesave dhe, i fundit, ndoshta në kohë, do të jetë procesi i trajtimit të pronës, sepse është më i gjati në kohë dhe ligji që është sot në fuqi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ai ka një ligj që është miratuar, ai i trajtimit të pronës, ku është lënë një afat i caktuar për përfundimin e procesit të trajtimit të pronës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo bëhet edhe sot. Për fat të keq kështu është miratuar ligji i legalizimeve në vitin 2006, kështu është edhe sot. Shteti ka hyrë në mes dhe thotë: “Ty të është zënë...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, nëse ai që ka ndërtuar është bataççi apo qytetar, ajo është çështje tjetër...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natyrisht që është i parregullt dhe këtë kemi kaq vite që e kemi thënë, sepse ndërtimi pa leje është fakt.

Të gjitha këto procese nuk mbyllen në një ditë dhe kanë një afat se kur do të përfundojnë. Si agjenci aty përfshihet ZRPP-ja, ALUIZNI, Agjencia e Regjistrimit të Pronave dhe Transferimit të Pronave, që është agjenci në Ministrinë e Brendshme, e cila bën transferimin e pronave të njësive vendore.

Në projektin fillestar ishte përfshirë edhe Agjencia e Trajtimit të Pronës, por u la për një moment të dytë për një arsye shumë të thjeshtë, sepse aktualisht shteti shqiptar është nëurvejim shumë të detajuar nga Këshilli i Europës për çështjen e pronës. Ligji i trajtimit të pronës e kaloi me zor provimin në Strasburg për mënyrën sesi ishte hartuar, sepse kemi bërë 4 ligje për pronat, që janë ndryshuar 400 herë në 27 vjet. Ligji i fundit, në momente të caktuara, dukej sikur prek interesat e pronarëve, por që është i vetmi real dhe mund t’u japë vërtet diçka. Ai ligj, që ju e keni diskutuar edhe këtu, pati shumë probleme për t’u kaluar në

Strasburg. Aktualisht jemi para procesit të fillimit të dhënieve të vendimeve të para të Gjykatës së Strasburgut mbi bazën e këtij ligji të ri. Në qoftë se ne do ta përfshinim këtu këtë ligj, menjëherë do të fillonin dyshimet, spekulimet politike që po na gënjejnë, po na ndryshojnë ligjin dhe me radhë. Kështu që, megjithëse unë gjykoj dhe jam i bindur se është e domosdoshme që Agjencia e Trajtimit të Pronës të jetë pjesë e këtij ligji dhe pjesë e këtyre proceseve, për të mos krijuar shqetësime të panevojshme, u gjykua të mbetet jashtë. Kur Gjykata e Strasburgut të fillojë të operojë mbi të dhe të japë vendimet e para, atëherë mund ta rishohim edhe çështjen e integritetit të saj brenda kësaj agjencie të madhe. E theksoj edhe një herë që në situatën aktuale është domosdoshme që edhe Agjencia e Trajtimit të Pronës të veprojë në harmoni dhe me të njëjtin legjislacion si agjencia e re e kadastrës.

Bashkimi i këtyre institucioneve në një dhe i mikroprocesve të tjera, që i bashkohen kësaj agjencie, çon automatikisht në zvogëlimin e personelit dhe të gjitha prapavijat e tyre shkurtohen. Nëse sot kemi 4 drejtori personeli, nesër do të kemi 1 drejtor personeli, në qoftë se sot kemi 4 drejtori shërbimesh, nesër do të kemi 1 drejtori shërbimesh, që nuk do të jetë bashkimi i këtyre që janë sot, por do të jetë personel më i reduktuar. Domethënë, në linja të përgjithshme do të ketë më pak punonjës dhe kjo për shkak të pakësimit të strukturave të prapavijës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në momentin e parë të bashkimit do të ketë 1 drejtori, por gjykoj që në të ardhmen, për shkak se të gjithë donatorët në vend, përfshirë këtu Bankën Botërore, BE-në dhe donatorë të tjerë si: SIDA, USAID-i e kështu me radhë, e kanë shtyrë shtetin shqiptar t'i hyjë kësaj pune dhe këtyre proceseve dhe janë të gatshëm qoftë për financim, qoftë për donacione, do të jetë e nevojshme të financohen proceset në terren. Pra, të heqim dorë nga strukturat burokratike në zyra dhe të jemi në funksion të proceseve në terren. Duhet pasur parasysh që kjo është Shqipëria dhe ka një limit të caktuar punonjësish që mund të angazhojë. Ne mund të themi që na duhen 1 mijë topografë, por nëse në Shqipëri ka vetëm 200, me ata do të punojmë ne dhe të gjithë institucionet e tjera që kanë nevojë për këto.

Zoti Shalsi preku çështjen e mjediseve të punës. Unë do të jap një shembull, ku situata është e tillë në shumicën e tyre. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës i ka zyrat në një godinë private, e cila është një qendër tregtare, ku në zyrat e krahut të majtë shkon dhe aplikon, pastaj punonjësit dalin në korridor, ku kalojnë njerëzit e qendrës tregtare, dhe hyjnë në zyrat e anës tjetër, ku janë arkivat. E theksoj edhe një herë që këtu bëhet fjalë për institucionin më historik të një vendi, jo në historinë e librave, por në historinë

ekonomike të një vendi. Imagjinoni në çfarë gjendje janë një pjesë e zyrave në këtë vend, ose janë me qira, ose janë pa zyra dhe janë të ftuara në godina të përkohshme, shumë pak janë në godina të ZRPP-ve dhe shumë pak nga këto janë në godina që e meritojnë këtë emër. Rasti i vetëm është godina e Tiranës, e cila është e ndërtuar në vitet '70, që është godinë e madhe, por që ka brenda 2-3 agjenci të tjera, të cilat duhet të dalin dhe t'ia lënë përfundimisht vendin kësaj agjencie. Ndërsa rastet e tjera janë të paimagjinueshme se në çfarë gjendje janë, jo vetëm të ZRPP-së, por edhe të ALUIZNI-t dhe agjencitë e tjera.

Çështja e sistemit të teknologjisë është pika kyçe, përtej të gjithave është çështja numër 1, sepse nëse nuk arrijmë dot të integrojmë sistemet e punës të këtyre agjencive me njëra-tjetrën, të cilat sot janë totalisht të ndara, pasi janë konceptuar të ndara pikërisht për t'u mos u marrë vesh me njëra-tjetrën, sepse ai që merrej me pronat thoshte që unë do ta mbaj këtu brenda dhe të mos e marrë vesh njeri, sepse më përzihen në këtë punë, ai i privatizimit thoshte: "Unë do ta mbyll këtu procesin dhe të mbaroj punë vetë", ai i legalizimeve kishte procesin e vet e të tjerë me radhë. Domethënë, të gjitha këto sisteme janë të ndara me koshiençë për të mos u integruar me njëri-tjetrin. Ky është boshti kryesor dhe nëse nuk arrihet integrimi i sistemeve, e reja këtu do të jetë vetëm që po bëjmë disa zyra të reja. Si nën pikë të kësaj, përfshij edhe çështjen e kapaciteteve njerëzore, gjithmonë me limitet e Shqipërisë. Sa herë fillon një investim i ri në Shqipëri, ne e ndjejmë mungesën e specialistëve. Për shembull, kur filloi punën TAP-i, të gjithë specialistët shkuan atje, kështu që ne kishim nevojë për punonjës, sepse i. Domethënë, sa herë fillon një aktivitet i madh ekonomik, kemi krizë punonjësish.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne po mendojmë të ngremë brenda institucionit një kurs trajnimi.

Lidhur me parashikimin kohor të proceseve, e thashë e dhe më parë, i pari që do të mbyllet është procesi i legalizimeve dhe i fundit do të jetë procesi i trajtimit të pronës, sepse vetë ligji e parashikon me afat 10-vjeçar, të gjitha të tjerat janë të parashikuara brenda këtyre limiteve.

Lidhur me pyetjen e zotit Baraj, për çështjen e legalizimeve tek Unaza e Madhe, nga pikëpamja formale-juridike legalizimet e bëra në kohë aty janë të rregullta, por nga pikëpamja morale çalojnë në dy gjëra:

Së pari, janë rreth 40 legalizime të bëra në periudhën korrik-shtator 2013. Pra, kishin lënë karrigen, por ende jo vulën, me të cilën vazhdonin bënin legalizime. Janë 40-42 legalizime në këtë periudhë, ku legalizimi i fundit është bërë më 3 shtator 2013.

Së dyti, edhe brenda kësaj, duke e ditur shumë mirë që Unaza do të zgjerohej, sepse pjesa tjetër e unazës nga Pallati me Shigjeta deri te Kopshti Botanik, e cila ishte shumë më e gjerë, kishte filluar të zgjerohej që në kohë të qeverisjes “Berisha”, nuk e kishin publikuar këtë projekt dhe të thoshin: “Vëllezër të dashur, ky është projekti i ri” dhe ky moslajmërim krijoi shteg për legalizimet aty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Natyrisht, lajmërimi nuk duhej thjesht me telefon, por t’i jepej një tagër zyrtar.

Nga ana tjetër, edhe në atë shtrat të ngushtuar të Unazës, që parashikonte projekti i vjetër i tyre, janë bërë legalizime të paligjshme, të cilat janë në shkelje, për të cilat Kryeministri tha që duhet të ndiqen penalisht.

Pyetja e zonjës Gjermani, nëse ligji i adreson të gjitha proceset, ne jemi munduar të tregohemi gjithëpërfshirës. Ju e thatë që sa më shumë të gërmosh, aq më shumë gjëra të reja zbulon, dhe ne jo më larg se para tri muajsh zbuluam një gjë të re, që e kemi propozuar në ligj, i cili nuk është përfshirë aty, por do të përfshihet me një VKM, që është procesi i shitjes së trojeve që kanë shpërndarë njësitë vendore. Këtu dua të përmend rastin e Sarandës, ku Bashkia Sarandë në vite ka ndarë troje nga 300-500 metra me një copë letër, që realisht nuk kishte tagër për shpërndarjen e tyre, ua ka ndarë qytetarëve, të cilët, mbi bazë të asaj letre kanë ndërtuar dhe kanë një leje të ligjshme ndërtimi mbi një truall, që në themel është e paligjshme, sepse bashkia ua ka dhanë këtë pa pasur tagër. Ky është një proces që e kemi zbuluar para tri muajsh dhe e kemi përfshirë si logjikë.

Ne kemi vënë një nen të veçantë në ligj, i cili i jep mundësi qeverisë që sa herë të lindin situata të tilla të reja, fasha të patrajtuara, të mund të trajtohen nëpërmjet një VKM-je.

Çështja e grupeve të interesit ka filluar që para 6 muajve me takime rajonale në të gjithë vendin. Ne kemi bërë takime rajonale me të gjithë personat e interesuar publikë apo privatë në Vlorë, Korçë, Fier dhe në Shkodër. Takimet nuk i kemi bërë në bazë qytetesh, por në bazë rajonesh, duke i thirrur të gjithë dhe duke u dhënë një draft të parë dhe duke u thënë: “Shprehni çdo lloj inputi që keni, institucione shtetërore dhe grupe interesi private”. Ky proces ka vazhduar edhe muajin e fundit. Ndërkohë, jemi duke marrë mendime nga institucione të profilit juridik.

Gjithashtu, po organizojmë disa tryeza me fakultetet juridike, me juristët dhe avokatët, tashmë për punimin juridik të ndonjë çështje, që ata e gjykojnë të nevojshme.

Zoti Suli, procesi i regjistrimit është procesi më i vështirë në të gjithë këtë histori, sepse kërkon reformimin themeltar të të gjithë ZRPP-së. Regjistrimi do të bëhet totalisht nga

e para, për shkak se shumica e pronave janë të regjistruara gabim, por edhe për shkak të shumë problematikave të mbartura, që po t'i themi këtu nuk mbarojmë dot deri nesër. Mjafton t'ju them vetëm njëërën prej tyre për të kuptuar.

Në përgjithësi e dimë historinë e mbivendosjes për shkak të deformimit të hartave, por edhe ato zona që janë regjistruar dhe hedhur në sistem, qoftë edhe gabim, por janë hedhur në sistem, edhe pse janë hedhur në sistem do të vazhdohet të punohet mbi bazën e sistemit, pra me sistem elektronik me fjalë të thjeshta. Janë hedhur në sistem dhe pastaj kanë vazhduar që të gjithë veprimet t'i bëjnë po në letër. Domethënë, është hedhur një zonë në sistem në vitin 2000 dhe të gjithë veprimet, shitblerjet dhe transaksionet, nuk janë hedhur në sistem, por të vazhdojnë në hartat e vjetra. Domethënë, transferimi i gjithë këtij bagazhi kolosal, pra të krijuar në këta 10 vjet në sistem kërkon shumë. Hipoteka ka rezistuar, pra gjithmonë ka pranuar epokën ku jeton, pra elektronikën.

Në qoftë se shikoni një pjesë të hartografisë që ka trashëguar hipoteka, ato hartat me vrima, ato vijnë për shkak se asnjëherë nuk kanë pranuar t'i dorëzohen shekullit XXI, por kanë vazhduar me shekullin XIX. Me gjithë punën e jashtëzakonshme të bërë, veçanërisht në 2 vjetët e fundit, që ka pasur një rakordim shumë të fortë midis nesh dhe ZRPP-së, ka pasur një impenjim personal, do të thosha deri në absurd, të Kryeministrit për ta detyruar hipotekën të pranojë risitë teknologjike. Këtu do të përfshija edhe një vendim të vitit 2015, që e detyronte hipotekën që aty kishte harta me probleme, të pranonte hartat e ALUIZNI-t dhe përsëri kanë bërë rezistencë edhe ndaj kësaj. Imagjinoni çfarë do të thotë hapja e të gjithë problematikave të regjistrimit që mbart hipoteka në vite.

Edmond Leka – Në vazhdim të pyetjes që ju bëri zonja Gjermani, për shkak të pyetjes së grupeve të interesit, dua të bëj një pyetje më konkrete: a do të ketë rivlerësim të pronave? Ne dimë që mbivendosja e pronave, sidomos në bregdet, është një problem shumë i madh. Shembull po marr Dhërmium një fshat me sipërfaqe 4500 hektarë dhe në zyrën e hipotekës në Vlorë figuron 15 mijë hektarë. Cili nga këta 4 pronarë të mbivendosur me njëri-tjetrin do të ketë prioritet?

Së dyti, në strukturën e re që ju do të bëni, a keni parashikuar punësim të agronomëve, sepse do të kemi të bëjmë me bonitetin e tokave, dhe më shumë se agronomët, askush nuk e njeh atë punë, sepse janë marrë vite të tëra me punën e tokave? Sa kohë do t'i duhet institucioni që të jetë funksional dhe të mos krijojë kaus të qytetarët? A duhet të informohen qytetarët që do të na duhet njëfarë kohe që ky institucion t'u përgjigjet kërkesave të tyre, duke mos krijuar probleme në marrjen e certifikatave të pronësisë?

Së fundi, si i keni menduar legalizimet selektive, a do të ketë ndjekje penale për ata që i kanë bërë këto legalizime selektive?

Faleminderit!

Andrea Marto – Faleminderit, për shpjegimet!

Së pari, pse jeni kaq optimist që këto dy projektligje aktuale do të zgjidhin të gjitha problemet e trashëguara, kur deri tani kemi parë se të gjitha ndryshimet ligjore ndaj këtyre viteve nuk kanë zgjidhur asgjë?

Së dyti, për pronat që nuk kanë probleme, a do të rinevojiten procedura regjistrimi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë të regjistruara, nuk janë problematika, a do të rinevojiten procedura? Për shembull, kam një apartament të regjistruar, nuk kam probleme. A duhet t'u drejtohem përsëri zyrave të reja?

Së treti, në organizimin që do të ketë njësia e re, struktura e re, a do të ketë drejtori varësie në të gjitha bashkitë, sepse tani nuk në të gjitha bashkitë?

Faleminderit!

Robert Bitri – Në vazhdim të asaj që tha Andrea, por që ngritën edhe shokët, ne, sipas asaj që thatë ju, kemi 1,3 milionë pasuri pa probleme. Ky 1,3 milionë, a do të ketë ndonjë rifillim të regjistrimit fillestar, siç ju e quani?

Së dyti, në ligj keni një vlerësim, që quani dokumenti origjinal. Cili do të jetë dokumenti origjinal? Kë do të quani ju dokument origjinal? Domethënë, edhe një vendim i Komisionit të Kthimit të Pronave, është privatizimi dhe ndarja e tokave, pra cili do të quhet origjinali i kësaj gjëje? Pra, probleme, siç është edhe tek Unaza, ka pasur në të gjitha ndarjet e tokave, hyrjet e parcelave, ndarja e tokave nga aksi i rrugës që thoshte 25 metër në të majtë dhe në të djathtë nuk duhet të ndahet, a do t'i regjistroni, a do të mbani qëndrime ndaj këtyre?

Aty ngrini një problem për vlerën, por mbase unë them që ta diskutojmë ditë tjetër, kur të kalojmë në shqyrtimin nën për nën aty. Do të thoni unifikimi. Çfarë presupozojmë me unifikimin e punës, të dokumentacionit, të metodikës në të gjithë unifikimin e të gjitha institucioneve?

Tatjana Nurçe – Faleminderit, zoti Lame!

Sigurisht, ju jeni i papërtuar në kthimin e përgjigjeve të të gjitha pyetjeve. Megjithatë, jam e fundit, dua të bëj një pyetje: në procesin e ligjësimit të aktit të

marrëveshjes të marrjes së tokës bujqësore, a do të bëhet vlerësim i ri i akteve që janë fituar me ligjin nr. 9948, apo do të kalojë në mënyrë elektronike në kadastër?

Vullnet Sinaj – Në përgjithësi u bënë pyetjet. Azhurnimi i tokave dhe mbivendosja e pronave janë problem i madh në të gjithë zonën. Rasti konkret është kur ekziston prona në terren, pra pronë e vjetër, dhe në zyrën e regjistrimit nuk ekziston, në këto raste si do të veprohet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eduard Shalsi – Në rregull me pjesën e pyetjeve?

Artan Lame – Doja ta nisja me një pyetje që ishte diku nga mesi, por që doja të ishte bërë në fill fare: pse jam kaq optimist?! Optimizmi vjen nga një arsye shumë e thjeshtë, sepse më keq nuk mund të bëhet. Domethënë, çfarë do që të bëjmë, do të jetë më mirë se sa jemi. E them këtë me seriozitet dhe me pretendimin e njeriut që e njeh sektorin. Më keq nuk mund të shkojë, kemi prekur fundin në të gjithë situatën e pronës në Shqipëri. Kështu që, çfarëdolloj gjëje që mund të bëjmë, edhe sikur ta bënim pa mend, do të jetë më mirë nga ajo që është, pra nga situata ku jemi. Shteti shqiptar në këtë proces për të ardhur deri këtu angazhoi të gjithë ekspertizën e mundshme të vendit dhe atë ndërkombëtare.

Meqenëse dolëm tek ekspertiza ndërkombëtare, kemi përdorur ekspertizë ndërkombëtare vetëm për çështjet e kadastrës, sepse për çështjet e proceseve të tjera nuk ekziston, jemi rast unikal në botë. Nuk ka vend tjetër të botës, që të ketë 20 e ca vjet, në të gjithë Lindjen, që merret me kthimin e pronave. E filluan në '91-shin dhe e mbyllën menjëherë, brenda 3-4 vjetësh. Pra, të gjitha proceset i hapën dhe i mbyllën brenda disa vjetësh, nuk ka asnjë vend tjetër që të jetë në vitin 2018 ende me të gjitha proceset e hapura. Kështu që, ne ekspertizë ndërkombëtare morëm vetëm për procesin e kadastrës, por jo për proceset e tjera, sepse jemi rast studimor.

Në lidhje me hierarkinë e regjistrimeve janë dy nene të veçanta në ligj, që merren me dy çështje: me hierarkinë e pronësimit dhe me hierarkinë e regjistrimit. Pikërisht bëjmë këtë renditje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, kur kemi mbivendosje titujsh, pra në një pronë të caktuar ka mbivendosje në disa tituj, së pari, ka precedencë titulli që ka edhe godinë. Pra, në qoftë se unë kam titull për këtë pronë, tjetri ka titull për këtë pronë, por edhe për godinën mbi këtë pronë, precedenca është e këtij që ka edhe godinë. Këto nuk janë zgjedhjet tona, por janë zgjedhjet që derivojnë edhe nga e drejta e përgjithshme, edhe nga Kodi Civil.

Hierarkia e dytë është ai që ka titull të transferuar, pra që ka kryer edhe transaksione me titullin. Pra, e ka blerë, jemi të dy që kemi titullin për këtë tokë, por ai që ia ka kaluar, dikujt tjetër, i cili më pas ua ka shitur dy të tjerëve e kështu me radhë, pra nuk shkojmë dot mbrapsht, që t'i hyjmë të gjithë procesit të shitblerjeve, ky ka precedencë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por, ka përparësi.

Në rastin e të dyve të njëjtën edhe në këtë situatë, ai që e ka titullin më të hershëm, pra kush e ka titullin të fituar më parë. Natyrisht, kjo është nga pikëpamja formale juridike, por nga pikëpamja morale mund të kemi sa të duash diskutime në këtë çështje. Ashtu siç na ndodhi sot, pra problematika që del te Fusha e Aviacionit, që thonë çfarë pronarësh ka aty, sepse ata janë pronarë me letra false, sepse ajo është blerë nga shteti. Të gjithë e dimë që ajo tokë ka qenë blerë nga shteti shqiptar kur është bërë fusha e aviacionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E shtetit shqiptar, sepse italianin nuk e bleu për vete. E ka blerë dhe është e kadastruar në emër të shtetit shqiptar. Problemi që ndodhi më pas është se komisionet e kthimit të pronave kanë vepruar duke mos e njohur këtë, por duke shkuar te pronari i mëparshëm, duke krijuar pronar të rinj. Sot ata janë pronarë të ligjshëm. Mund të jemi moralisht jo dakord, por është vetëm një gjykatë që mund të thotë nëse është i ligjshëm apo i paligjshëm ky kthim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, si shkolla "Kosova" dhe si shumë raste të tjera të kësaj kategorie. Pra, ligjërisht është një gjë dhe moralisht është një tjetër gjë.

Punësimi i agronomëve: ishalla na vijnë agronomë, sepse në shumë raste detyrohem të marrim njerëz pa përgatitjen profesionale minimale për shkak të mangësive. Personalisht, kam dalë disa herë në televizor dhe kam bërë thirrje për punësime dhe vazhdoj të bëjë thirrje për punësime të llojit inxhinier, topograf dhe gjeodet, pra për këto fusha, le të vijnë nesër në derën tonë dhe pasnesër janë të punësuar. Pra, fushat direkt profesionale, por ka limitet e saja dhe për këtë arsye po skemojmë ngritjen e një kursi trajnimi të brendshëm, profesional.

Për legalizimet selektive e thashë, madje e tha edhe Kryeministri, ne do të fillojmë procedurat për ato legalizime që janë bërë në kundërshtim edhe me vetë ligjin në fuqi. Për të qenë i qartë dhe ballëhapur, legalizime me probleme ka edhe pas vitit 2013. Në qoftë se ata bënë 20 mijë, nga të cilat 10 mijë janë me probleme, dhe unë në këtë sallë kam qenë me ju, kur kam thënë se i gjithë arkivi është plot me probleme të trashëguara, bujrum, çdo

institucion që do të penalizojë, të vijë dhe t'i hapë, por ne në atë kohë nuk mund ta kthenim institucionin në gjykatë për t'u marrë me të shkuarën, sepse duhet të shihnim përpara. Por legalizime me probleme janë bërë edhe në kohën tonë, janë rreth 150 mijë legalizime me probleme që nuk duheshin bërë. Natyrisht që janë 1 në 1000, por sidoqoftë duhet ta pranojmë që ka pasur probleme me vetëdije dhe pavetëdije. Por gjykoj se në shumicën e rasteve kanë qenë të pavetëdijshme për mangësi koordinimi, mungesë dokumentacioni e kështu me radhë. Jemi të hapur dhe vazhdojmë të jemi të hapur për të gjithë institucionet sa herë që kanë dashur të bëjmë transparencë dhe të bëjnë verifikime.

Pyetja a do të ketë reregjistrim të pronave, është shumë e rëndësishme për të gjithë qytetarët. Themeli i ligjit të kadastrës merr rrol proaktiv, pra nuk është si më parë që rrinim dhe prisnim qyqarin e radhës që ka hall, por do të jetë institucioni, i cili do të merret me regjistrimin. Kjo do të thotë që ai qytetar që e ka e të saktë regjistrimin do të rrijë i qetë në shtëpinë e tij, sepse letrën do ta ketë të ligjshme, pra 1 milion e 300 mijë pronat e reregjistruara saktë do të jenë të vlefshme. Agjencia e re do të merret me përmirësimin e 2 milionë pronave me probleme dhe regjistrimin e pronave të paregjistruara, pra me proceset e pambyllura.

Pyetja e fundit kishte të bënte me ndërtimet para vitit 1991. Është vendimi i dalë në korrik të këtij viti, i cili mundëson regjistrimin e banesave të paregjistruara të ndërtuara para vitit 1991. Ka një listë dhe një procedurë shumë të thjeshtësuar, mjafton që qytetari të vërtetojë që e ka pasur atë banesë përpara vitit 1991 dhe të marrë për sipër nëse do të ketë probleme ndarje me bashkëfamiljarët e vet, atëherë bëhen matjet në terren nga ana jonë, sepse do të hidhet në kadastër dhe regjistrohet objekti mbi bazën e procedurës. Rastet e para të kësaj procedure, pra, të regjistrimit të ndërtesave, do t'i bëjmë nesër në Shkozë.

Pyetja, a do të mbahet qëndrim për regjistrimet e paligjshme. Kjo është një pyetje shumë e rëndësishme. Shteti shqiptar në 20 e ca vjet ka bërë të pamundurën që të bllokojë veten për të rregulluar gjërat, që do të thotë, kohë pas kohe ose i ka hequr kompetencat vetes ose ka shkuar puna në gjykata, përfshirë këtu Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese, ku kanë nxjerrë vendime që kanë penguar shtetin në çdo kohë që të marrë dhe të rregullojë situata negative të trashëguara. Aktualisht janë të limituara mundësitë ligjore që shteti shqiptar të rregullojë situata të paligjshme. Pra, ne mund të ulemi të verifikojmë të gjithë letrat dhe të themi që ky vendim i Komisionit të Kthimit të Pronave është i paligjshëm, është kriminal apo kjo AMTP e dhënë në bregdet apo në rrëzë është e paligjshme dhe kriminale, nuk kemi asnjë mundësi ligjore për ta rregulluar. Kjo, sepse vetë shteti në këta 20 vjet, për interesa shumë të

vegjël, meskin ndonjëherë dhe të paimagjinueshëm të një prokurori, gjykatësi apo ministri, pra të një funksionari të caktuar, i ka hequr mundësinë vetes për të rishikuar situatat e paligjshme.

Të mos harrojmë që komisionet e ndarjes së tokës në fshat kanë qenë të një niveli kulturor, ligjor dhe formues më poshtë sa nuk kishte ku të vente. Ata mblidheshin 3 veta në fshat, firmosnin një copë letër që të bënte pronar, pastaj mund të mblidhet një shtet i tërë dhe nuk është në gjendje ta ndryshojë, sepse ia ka hequr vetes çdo lloj mundësie ligjore për ta verifikuar dhe për vënë të drejtën në vend mbi këto akte marrjesh. Të tilla kanë qenë vendimmarrjet e Komisioneve të Kthimit të Pronave në fshat dhe në qytet, që kanë sjellë këtë kaos sot.

Po përmend edhe një element të fundit, që është ajo e pronave të sindikatave, e cila është një vrimë tjetër e madhe në këtë vend. Kjo është një pronë e madhe e vënë nga të gjithë shqiptarët, që tani e gëzojnë ca krerë sindikatash që nuk i njeh askush dhe që nuk kanë asnjë peshë reale me punëtorët e tyre, por që menaxhojnë një pasuri të paimagjinueshme të këtij vendi. Shteti shqiptar ia ka hequr me qëllim vetes mundësinë për t'i marrë në zotërim dhe për t'i menaxhuar këto kategori pronash.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, të kërkoj ndjesë. Sistemi i sotëm është: ALUIZNI funksionon me 21 drejtori në territor, ZRPP-ja me 35 drejtori në territor, ATP-ja me një drejtori në Tiranë dhe Agjencia e Regjistrimit të Pronave në shtet funksionon me drejtorinë në Tiranë, por pa degë. Kjo është situata e tyre duke lënë mënjane ATP-në që mbetet momentalisht jashtë. Agjencia e Regjistrimit të Pronave në shtet dhe ajo e Transferimit të Pronave integrohet brenda.

Pikësynimi për formatin e punës është që në çdo bashki duhet të ketë sportel dhe në çdo qendër qarku, në nivel rajonal, pra në 4 rajone të ketë arkiv fizik. Pra sporteli të jetë në çdo bashki për të shkuar sa më pranë qytetarit ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është pikësynimi. Aktualisht do të punohet me 35 ZRPP, sepse atë ka njerëz në terren. Kjo bëhet me synimin që brenda dy vjetësh në çdo bashki të ketë sportel për qytetarët dhe në çdo qendër qarku të ketë arkiv, meqenëse do të shkojnë drejt integritetit të rrjeteve, siç e tha edhe zoti Shalsi, pra do të punohet në rrjet dhe nuk do të ketë nevojë për të hapur librin. Kjo është arsyeja e parë.

E dyta, meqenëse ne çdo 20 vjet e djegim vendin, duke e grumbulluar arkivin në pak pika është më kollajshme ta shpëtojmë.

Eduard Shalsi – Fjalën e ka zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit për prezantimin dinjitoz!

Ju thatë: “Çfarëdo që do të bëjmë me këtë ligj, ne do të bëjmë më të mirën e mundshme”. Ne e dimë shumë mirë se sa ka vuajtur ky vend dhe ju bëtë një historik të reformave për tokën në vendin tonë, kjo ishte reforma e gjashtë, që qoftë e fundit dhe mos pastë më pas saj. Pra, nisur nga fjala juaj: që kjo është më e mira, por përsëri do të ketë probleme, dua t’ju bëj një pyetje: pse mendoni kështu? Çfarë problemi mund të ketë që edhe kjo reformë mund të krijojë hapësira dhe mund të mos e zgjidhë përfundimisht këtë problem, pasi mendoj se ky është problemi më i madh që ka Shqipëria sot. Pjesa më e madhe e popullsisë shqiptare është e lidhur me tokën. Pra, ka 27 vjet që nuk ka filluar kapitalizmi në ekonominë bujqësore, sepse pa pasur pronën nuk ka shitblerje, nuk ka dhënie me qira dhe nuk mund të vijnë investitorë të huaj, se nuk dinë ku të mbështeten. Pra, një investitor serioz nuk mund të investojë, sepse nuk di se si ta bëjë marrëveshjen me pronarin e tokës, a t’ia marrin me qira apo t’ia blejnë kur nuk ekziston.

Unë nuk dua që të jemi në parlament dhe të krahasohemi me deputetët që u morën me ligjin nr. 7501, i cili nuk u zbatua asnjëherë dhe dua të di se çfarë do të ndodhë. Duhet ta themi realitetin ashtu siç është. Në Veriun e Shqipërisë është ndarë toka dhe nuk ka gjetur zbatim. Në Shqipërinë e mesme dhe në Jug ka një zbatim të gabuar. Çfarë do të ndodhë?

Ju keni pasur kohë një vit e ca si Komision, nga vendimi i Kryeministrit për mbledhjen e këtij Komisioni, dhe ne na keni lënë pak kohë për të diskutuar mbi këtë, mos ndoshta duhet më shumë kohë që ta diskutojmë që të mos kemi më një ligj tjetër? Çfarë na pengon që kjo të jetë reforma e fundit? Kërkoni çfarë na duhet që ta bëjmë dhe t’i japim fund kësaj historie kaq të rëndësishme për këtë vend. Kjo do të ndikojë në moslargimin e të rinjve nga Shqipëria dhe në kthimin e atyre që punojnë në bujqësi në vendet fqinjë, si Greqi dhe Itali. Ata nuk kanë përse të punojnë atje kur kanë tokat e tyre.

Ne kemi projektin IPARD dhe rrezikojmë të mos kemi shumë fitues për arsye të certifikatës së pronësisë. Po ta kishim këtë mundësi, e them me bindje të plotë që do të kishim kthim të shqiptarëve nga vendet europiane, sidomos atyre që punojnë në bujqësi. Do t’ju lutesha të na thoshit se çfarë mund të bëjmë që të mos t’i kthehemi më mbrapsht kësaj reforme kaq të rëndësishme dhe uroj që kjo reformë të jetë e fundit.

Faleminderit!

Artan Lame – Lidhur me atë që thashë, që nuk mund ta bëjmë më keq, lidhet me një citat nga ligji i Mërfit ku thotë: “Nuk mund të biesh nga dysHEMEJA”. Ne kemi arritur në dysHEME dhe kjo është e mira e kësaj pune për situatën e pronës në Shqipëri. Ne ose do të vazhdojmë të gëlojmë në këtë situatë amorfiteti të luftës së bërrylave, pra unë shtyj komshiun dhe komshiu më shtyn mua dhe kush të jetë më i fortë mban këtë, ose do t’i hyjmë procesit reformues. Në këtë pikëpamje thashë që më keq nuk e bëjmë dot.

Themeli i reformës nuk janë ligjet, sepse ligjet në këtë vend janë bërë pa fund. Këtë nuk e them për të zhvlerësuar ligjet e bëra, sepse janë realisht të mira. Kjo jo se kam qenë pjesë e atij grupi pune, ku aktivizimi njerëzor dhe intelektual i të gjithëve ka qenë maksimal, por sepse nuk kanë asnjë vlerë ligjet nëse nuk ka vullnet politik. Më rezulton që deri tani në 5 vjet vullneti politik si për procesin e parë të legalizimeve, ashtu edhe për procesin e përfundimit të pronësisë ka ekzistuar. Ditën që vullneti politik nuk do të ekzistojë, të rrofshin ligjet e mira, sepse do të bjerë menjëherë e gjitha. Në këtë aspekt e them që të jetë e fundit. Pra, për sa kohë do të ketë vullnet politik, që deri tani është demonstruar nga kjo qeveri dhe nga kjo maxhorancë, do të funksionojë. Nëse vjen një maxhorancë që e abandonon procesin, përsëri do të bjerë në kaos. Shpresoj që çdo maxhorance, që do të vijë në të ardhmen, të mos jetë aq e marrë që të frenojë apo të ndërpresë këtë proces, që për fat dhe për vullnetin e saj i ra kësaj maxhorance që ta nisë. I mbetet maxhorancës së ardhshme që ta fillojë Shqipërinë nga fillimi, por më duket e vështirë që të ketë maxhorancë tjetër që të jetë në gjendje që të bëjë diçka ndryshe nga kjo shinë ku ne po e vendosim historinë e pronës në Shqipëri.

Eduard Shalsi – Duke falënderuar të ftuarit, edhe zonjën zëvendësministre edhe zotin Lame dhe ekipin e tyre që i shoqërojnë, por edhe kolegët për pyetjet dhe komentet, ne e hapëm siparin e diskutimeve dhe do të vijomë debatet edhe gjatë diskutimit nën për nën. Besoj se do të kemi kohën e mjaftueshme, zonja Gjermani, për të reflektuar dhe për të parë nëse ka komente, propozime dhe vërejtje. Nuk e di cilat mund të jenë grupet e interesit që mund të ftojmë në komision, por ne kemi hapur siparin e diskutimeve, njoftimet janë të publikuara edhe në *website* shpresojmë të kemi angazhim edhe nga shoqata dhe individë të ndryshëm.

Vlen të përmendet që ligji i vitit 2015, mbi çështjet e pronësisë, ka marrë dakordsinë nga Komisioni i Venecies dhe Komisioni European dhe është drejt zbatimit, si për kompensimin financiar, ashtu edhe për atë fizik, pasi ka qenë një debat që ne e kemi bërë edhe në këtë komision. Pra, kemi kushtet, eksperiencën dhe tashmë të gjitha premiset ekzistojnë për të ndërtuar një ligj adekuat mbi të cilin do të lindin dhe institucionet e reja.

Sfida mbetet, ne si komision kemi një praktikë të mirë me ALUIZNI-n dhe herë pas here kemi organizuar dëgjesa, një herë në gjashtë muaj, të cilat na kanë mbajtur më të azhurnuar, por edhe pjesën e raportimit e kanë përmirësuar. Ky është një ligj që ne duhet ta monitorojmë me shumë kujdes, sepse gjë tjetër është të jetë në letër dhe gjë tjetër është të aplikohet. Mbështetja jonë si deputet nuk do t'ju mungojë, sepse siç e tha edhe zoti Sinaj, mrekullira nuk bëjmë dot, por pa zgjidhjen e çështjes së pronësisë dhe pa i dhënë fund disa proceseve që duhet të ishin tranzitore ne nuk duhet të pretendojmë të bëjmë një hap të madh cilësor.

Edhe një herë faleminderit dhe do të jemi në kontakt. Nesër kemi diskutimin e ligjit të turizmit dhe pastaj do të vijojmë me roming pasnesër.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA